



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 maj 2022
Nr.ref.:RK 1991/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI125/21

Parashtrues

Armend Osaj

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit PML. nr. 212/2021 të Gjykatës Supreme të Republikës së
Kosovës, të 10 qershorit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Armend Osaj (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Deçan, i cili përfaqësohet nga Shoqëria e Avokatëve "Sejdiu & Qerkini" sh.p.k.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [PML nr. 212/2021] të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të 10 qershorit 2021 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).
3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 21 qershor 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i është shkelur e drejta e tij e garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetua), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt gjyqësor) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNj).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës dhe nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 5 korrik 2021, kërkesa u dorëzua në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 14 korrik 2021, Kryetarja e Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).
8. Më 16 korrik 2021, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 11 maj 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të shpallë kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar.

Përmbledhja e fakteve të rastit

10. Më 29 mars 2021, Prokuroria Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Prokuroria Themelore), nxori aktvendimin për fillimin e hetimeve ndaj parashtruesit të kërkesës dhe 3 (tre) personave të tjerë, për shkak të dyshimit të bazuar për kryerjen e disa veprave penale. Parashtruesi i kërkesës dyshohej për

kryerjen e veprave penale të: (i) keqpërdorimit të detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 414, paragrafi 2 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPRK); (ii) përvetësimit në detyrë nga neni 418, paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 të KPRK-së; dhe (iii) falsifikimit të dokumenteve zyrtare nga neni 427, paragrafi 1 të KPRK-së.

11. Më 30 mars 2021, Prokurori i çështjes parashtroi kërkesë [PP. I. nr.23K/21] në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore), për caktimin e masës së paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës dhe 3 (tre) personave të tjerë, të dyshuar për kryerjen e veprave penale të lartpërmendura.
12. Më 30 mars 2021, me urdhër të Prokurorit të çështjes, parashtruesi i kërkesës (ora 09:00) u arrestua nga Policia e Republikës së Kosovës. Pas përfundimit të intervistimit, parashtruesi i kërkesës u dërgua në mbajtje për 48 orë.
13. Më 31 mars 2021, parashtruesi i kërkesës (ora 13:15) u dërgua para gjyqtarit të procedurës paraprake në Gjykatën Themelore. Pas dëgjimit të mbrojtjes së parashtruesit të kërkesës dhe mbrojtësve të 3 (tre) personave të tjerë, seanca dëgjimore përfundoi në 15:10.
14. Më 31 mars 2021, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin [PPrKR. nr. 234/2021], nëpërmjet të cilit parashtruesit të kërkesës iu caktua masa e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, bazuar në nenin 187, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe 1.2, pikat, 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPRK), duke ia llogaritur paraburgimin nga momenti i arrestimit, i 30 marsit 2021. Gjykata respektive vlerësoi se ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit kanë kryer veprat penale dhe se plotësohet kushti i përgjithshëm, dyshimi i bazuar i paraparë me nenin 187, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. i KPRK-së, si bazë ligjore e përgjithshme për caktimin e masës së paraburgimit. Përveç kësaj, gjykata respektive konstatoi se janë plotësuar edhe kushtet e veçanta sipas KPPRK-së për t'i mbajtur të pandehurit në paraburgim.
15. Parashtruesi i kërkesës, brenda afatit ligjor, parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktvendimit të lartcekur, për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që ankesa të aprovohet dhe aktvendimi të ndryshohet, si dhe ndaj parashtruesit të kërkesës të ndryshohet masa e paraburgimit me një masë më të butë alternative, siç është arresti shtëpiak, dorëzania apo masa e paraqitjes në stacionin policor, apo masë tjetër më të butë.
16. Më 8 prill 2021, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin [PN1. nr. 341/2021], nëpërmjet të cilit, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore, të 31 marsit 2021, me arsyetimin se: *"... gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë kur të pandehurve u ka caktuar masën e paraburgimit, ngase masat e tjera të parapara nga neni 173 të KPPRK-së, janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së tyre në procedurë, në rrjedhjen normale të procedurës penale dhe në parandalimin e kryerjes apo përsëritjes së veprave penale, prandaj me qëllim të zbatimit me sukses të*

procedurës penale, caktimi i paraburgimit konsiderohet si i domosdoshëm, kurse ankesat e mbrojtësve të pandehurve janë refuzuar si të pabazuara”.

17. Parashtruesi i kërkesës ushtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe procedural.
18. Më 19 prill 2021, Prokurori i Shtetit, nëpërmjet shkresës KMLP. III. nr. 41/2021, propozoi që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, e ushtruar nga mbrojtja e parashtruesit të kërkesës, të refuzohet si e pabazuar.
19. Më 22 prill 2021, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin [PML/132/2021], nëpërmjet të cilit (i) aprovoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, anuloi aktvendimet e goditura të instancave më të ulëta, ktheu çështjen në rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë, dhe (ii) vendosi që parashtruesi i kërkesës të qëndrojë në paraburgim deri në marrjen e një vendimit të ri, me arsyetimin se aktvendimet e kontestuar janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 12.1 i KPPRK-së, pasi që gjykatat e instancave më të ulëta nuk kanë bërë përshkrimin e provave, respektivisht nuk kanë dhënë arsye dhe nuk i kanë specifikuar rrethanat dhe provat konkrete për rrezikun e ikjes, ndikimit në dëshmitarë si dhe rrezikun e përsëritjes së veprës penale konform nenit 187, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, pika 1.2.1, 1.2.2 dhe 1.2.3 të KPPRK-së për të cilat baza i është caktuar paraburgimi.
20. Më 28 prill 2021, Gjykata Themelore, bazuar në kërkesën e Prokurorit themelor për vazhdimin e paraburgimit, nxori Aktvendimin [PPrKR. nr. 234/21], nëpërmjet të cilit ia vazhdoi parashtruesit të kërkesës masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, gjegjësisht deri më 29 qershor 2021, për shkak të dyshimit të bazuar se parashtruesi i kërkesës dhe një i pandehur tjetër kanë kryer veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtarë nga neni 414, paragrafi 2 i KPRK-së, përvetësimit në detyrë, nga neni 418 paragrafi 1, i KPRK-së dhe falsifikimit të dokumenteve zyrtare nga neni 427, paragrafi 1 i KPRK-së.
21. Kundër aktvendimit të lartcekur, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar në shkelje të dispozitave të ligjit penal dhe procedural, me propozimin që të aprovohet ankesa, të anulohet aktvendimi i kontestuar [PPrKR. nr. 234/21], ose të ndryshohet i njëjti, të ndërpritet paraburgimi ose të aplikohet masa e arrestit shtëpiak.
22. Më 11 maj 2021, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin [PN1. nr. 468/2021], nëpërmjet të cilit, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore, të 28 prillit 2021, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë kur të pandehurve ua ka vazhduar masën e paraburgimit, ngase masat tjera të parapara nga neni 173 të KPPRK-së, i konsideroi të pamjaftueshme për të siguruar prezencën e tyre në procedurë penale, si dhe rrjedhjen normale të procedurës dhe parandalimin e kryerjes apo përsëritjes së veprave penale.

23. Më 25 maj 2021, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave të ligjit penal dhe për shkak të shkeljes së parimit të prezumimit të pafajësisë.
24. Më 10 qershor 2021, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin [PML. nr. 212/2021], nëpërmjet të cilit refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, ushtuar nga parashtruesi i kërkesës kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [PN1. nr. 468/2021], të 11 majit 2021, me arsyetimin se *“Kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin e pretendimeve dhe kanë dhënë arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë, ndërsa masat tjera të parapara nga neni 173 të KPPK janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të akuzuarit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si rezultat i shkeljes së parimit të prezumimit të pafajësisë.
26. Përkitazi me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës fillimisht argumenton se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit: *“... i referohet parashtruesit si person i dyshuar në të gjitha pjesët tjera të tij. Në këtë mënyrë, duket se Gjykata e Apelit ka përdorur deklarimin e kontestuar, jo për të shpallur parashtruesin fajtor, por për të arsyetuar paraburgimin e tij. Sidoqoftë, mungesa e qëllimit për të shkelur parimin e prezumimit të pafajësisë nuk përjashton cenimin e nenit 6.2 të Konventës dhe Gjykata ka gjetur në shumë raste shkelje të nenit 6.2 për shkak të deklarimeve të parakohshme për fajësi, në vendimet për caktimin e paraburgimit. Në këtë kontekst parashtruesi i referohet rastit të GjEDNJ-së, Gutsanov kundër Bullgarisë, aplikimi nr.34529110, paragrafët 201-04, ku e njëjta konsideroi se deklarimi i kontestuar nuk ishte i kufizuar në përshkrimin e "situatës së dyshimit " kundër parashtruesit, por ai e paraqiste parashtruesin si person i cili kishte kryer vepër penale, pa ndonjë cilësim apo rezervim (krahaso rastin Maskim Savov kundër Bullgarisë, aplikimi nr. 28143/10, Vendimi i 13 tetor 2020, paragrafi 73). Prandaj, mënyra e përgjithshme se si është bërë deklarimi nga ana e Gjykatës së Apelit bartë rrezikun që tek publiku të mos lë mëdyshje se parashtruesi ka kryer veprën penale në fjalë [...]”*.
27. Tutje, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, i 10 qershorit 2021, ka shkelur po ashtu të drejtën e tij që të prezumohet i pafajshëm, përderisa nuk është dëshmuar fajësia e tij në pajtim me ligjin dhe siç përcakton neni 31, paragrafi 5 i Kushtetutës dhe neni 6.2 i KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës argumenton se Gjykata Supreme vlerësoi se *“Ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit, edhe në pajtim me nenin 187, para. 1 nënparagrafi 2 pika 1.2.3 të KPPK-së, duke pasur parasysh natyrën dhe peshën*

e veprave penale, mënyrën dhe rrethanat në të cilën janë kryer veprat penale, ku i pandehuri veprat penale i ka kryer në cilësinë e personit zyrtar dhe së bashku me të pandehurit tjerë, duke ndërmarrë veprime të kundërligjshme, kanë fituar vlera të mëdha të parave, andaj nëse llogariten telefonat të cilët mungojnë, e që janë 387 telefona, me një shumë totale prej 327 mijë e 514 euro (pa TVSH), ndërsa me TVSH shuma e blerjes është 454 mijë e 441 euro, lë të besohet se me lëshimin e të pandehurit në liri mund të vijë deri te përsëritja e veprave penale apo kryerja e ndonjë vepre tjetër të natyrës së njëjtë”. Sipas parashtruesit të kërkesës, arsyetimi i mësipërm në mënyrë shprehimore shpreh paragjykim për sa i përket fajësisë së tij, në ndërkohë që fajësia e tij ende nuk është vërtetuar nëpërmjet shqyrtimit kryesor gjyqësor dhe se ai nuk ka pasur ende mundësi të shprehet për pretendimet dhe provat e Prokurorisë lidhur me akuzat ndaj tij.

28. Pavarësisht kësaj, parashtruesi i kërkesës thekson se në Aktgjykimin e kontestuar Gjykata Supreme shërbehet me fjalë dhe fraza qartazi sugjестive dhe paragjyquese, për fajësinë e tij, ku thekson: “[...] duke pasur parasysh natyrën dhe peshën e veprave penale, mënyrën dhe rrethanat në të cilën janë kryer veprat penale, ku i pandehuri veprat penale i ka kryer në cilësinë e personit zyrtar dhe së bashku me të pandehurit tjerë, duke ndërmarrë veprime të kundërligjshme, kanë fituar vlera të mëdha të parave [...]”. Sipas parashtruesit të kërkesës, formulimi i mësipërm i Gjykatës Supreme në mënyrë të qartë shpreh opinion se ai është fajtor edhe para se fajësia e tij të provohet në përputhje me ligjin.
29. Tutje, parashtruesi i kërkesës argumenton se me asnjë fjalë apo sqarim të vetëm Gjykata Supreme, në këtë pjesë të arsyetimit të saj, nuk ka shpjeguar se në këtë fazë të procedurës penale nuk mund të flitet për kryes të veprës penale dhe kryerje të veprës penale por mund të bëhet fjalë vetëm për dyshim për kryerje të veprës penale, person të dyshuar për kryerje të veprës penale, pretendime për veprime të kundërligjshme, pretendime për përfitime të kundërligjshme pasurore. Në ndërlidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se në rastin e tij vlen standardi i ndërtuar nga GJEDNJ, përkitazi me prezumimin e pafajësisë, ku GJEDNJ në disa raste ka përcaktuar se “prezumimi i pafajësisë cenohet kur deklaratimet, shprehjet e bëra në arsyetimet e vendimeve të gjykatave, para se të vërtetohet fajësia e të pandehurve në mënyrë ligjore, nuk kufizohen në përshkrimin e situatës së dyshimit ndaj të pandehurve, por i paraqesin ata si persona të cilët kanë kryer vepër penale”, duke iu referuar konkretisht rasteve *Avaz Zeynalov kundër Azeberejxhanit*, të 22 prillit 2021, paragrafi 70 dhe *Maksim Savov kundër Bullgarisë*, të 13 tetorit 2020, paragrafi 73.
30. Parashtruesi i kërkesës tutje thekson se interpretimet e GJEDNJ-së duhet të shihen në dritën e nenit 53 të Kushtetutës, i cili i detyron gjykatat dhe institucionet publike në Republikën e Kosovës që të drejtat e njeriut që i garanton Kushtetuta t’i interpretojnë në harmoni me jurisprudencën e GJEDNJ-së. Në ndërlidhje me këtë, parashtruesi mëton se është shumë me rëndësi të vihet theksi në arsyetimin që ka dhënë GJEDNJ, në konstatimin e shkeljes së prezumimit të pafajësisë në rastin *Avaz Zeynlov kundër Azerbajxhanit*, ku sipas tij GJEDNJ ka arsyetuar se: “... se asnjë vendim pasues i gjykatave vendore nuk ka përmirësuar (korrektuar) formulimin në fjalë të Gjykatës së Apelit në Baku”.

31. Tutje, parashtruesi i kërkesës thekson se shkelja e parimit të prezumimit të pafajësisë të shkaktuar nga Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme vë në dyshim edhe paanshmërinë e gjykatës. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës argumenton se “paanshmëria e gjykatës” është fakt i prezumuar procedural derisa nuk provohet e kundërta. Megjithatë, parashtruesi në lidhje me këtë pretendim thekson se *“Në këtë fazë ne nuk pretendojmë se kemi ndonjë provë apo argument për të mbështetur dyshimin për ndonjë paragjykim apo anim të qëllimshëm të gjyqtareve që do të vinte në pikëpyetje paanshmërinë e tyre personale”*. Sidoqoftë, sipas tij, fakti se gjyqtarët e Gjykatës Supreme që gjykuan këtë rast, kanë shkelur prezumimin e pafajësisë në këtë fazë të procedurës penale, pa filluar ende shqyrtimi gjyqësor, krijon shqetësim legjitim dhe frikë të arsyeshme tek ai se ky fakt do ndikojë tek Gjykata Supreme, sikundër edhe tek gjykatat e shkallës më të ulët, që të prirën apriori për të shpallur parashtruesin e kërkesës fajtor.
32. Në fund, parashtruesi i kërkesës nga Gjykata kërkon të konstatojë se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme PML. nr. 212/2021, i 10 qershorit 2021, ka shkelur prezumimin e pafajësisë të garantuar me nenin 31.3 të Kushtetutës dhe nenin 6.2 të KEDNj-së në dëm të parashtruesit të kërkesës.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

[...]

5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

[E drejta për një proces të rregullt gjyqësor]

[...]

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

[...]

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës

Neni 3

Prezumimi i pafajësisë së të pandehurit dhe *in dubio pro reo*

1. Çdo person i dyshuar ose që akuzohet për vepër penale konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës.

2. Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të

pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Pranueshmëria e kërkesës

33. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

35. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha

rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ...”.

36. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; e konteston kushtetutshmërinë e një akti të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin Pml. nr. 212/2021 të Gjykatës Supreme, të 10 qershorit 2021; i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; i ka specifikuar qartë të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, ashtu siç përcaktohet me nenin 48 të Ligjit; dhe se kërkesën e ka dorëzuar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç përcakton neni 49 i Ligjit.

37. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht rregullin (2) të Rregullores së punës, që përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

38. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNj-së (shih, rastin e GjEDNj-së *Trofimchuk kundër Ukrainës* (vendim) nr. 4241/03 i 31 majit 2005; shih gjithashtu *Baillard kundër Francës* (vendim) nr. 6032/04 i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës KI166/20, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43); dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GjEDNj-së, *Kemmachev kundër Francës*, Aplikimi nr. 17621/91, kategoria (i); *Mentzen kundër Lituanisë*, Aplikimi nr. 71074/01, kategoria (ii); dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës*, Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii)).

39. Gjykata fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, i janë shkelur të drejtat e tij të

garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.2 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të KEDNj-së.

40. Gjykata gjithashtu rikujton se rrethanat e rastit ndërlidhen me Aktvendimin e Gjykatës Themelore për fillimin e hetimeve ndaj parashtruesit të kërkesës dhe 3 (tre) personave të tjerë, për shkak të dyshimit të bazuar për kryerjen e disa veprave penale: i) keqpërdorimit të detyrës zyrtare apo autoriteti zyrtar, nga neni 414, paragrafi 2 i KPRK-së; (ii) përvetësimit në detyrë nga neni 418, paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 të KPRK-së; dhe (iii) falsifikimit të dokumenteve zyrtare, nga neni 427, paragrafi 1 të KPRK-së. Prokurori i çështjes parashtroi kërkesë [PP. I. nr. 23K/21] në Gjykatën Themelore për caktimin e masës së paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës dhe 3 (tre) personave të tjerë, të dyshuar për kryerjen e disa veprave penale. Me urdhër të Prokurorit të çështjes, parashtruesi i kërkesës u arrestua nga Policia e Republikës së Kosovës, e pas përfundimit të intervistimit parashtruesi i kërkesës u dërgua në mbajtje, për 48 orë. Më 31 mars 2021, parashtruesi i kërkesës u dërgua para gjyqtarit të procedurës paraprake në Gjykatën Themelore. Më 31 mars 2021, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin [PPrKR. nr. 234/21], me të cilin parashtruesit të kërkesës ia caktoi masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, duke ia llogaritur paraburgimin nga momenti i arrestimit, 30 marsi 2021. Gjykata respektive vlerësoi se: (i) ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit kanë kryer veprat penale dhe se plotësohet kushti i përgjithshëm, dyshimi i bazuar i paraparë me nenin 187, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. i KPRK-së, si bazë ligjore e përgjithshme, për caktimin e masës së paraburgimit; dhe se (ii) janë plotësuar edhe kushtet e veçanta sipas KPPRK-së, për t'i mbajtur të pandehurit në paraburgim. Parashtruesi i kërkesës, brenda afatit ligjor, parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të lartcekur, për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që ankesa të aprovohet dhe aktvendimi të ndryshohet, si dhe ndaj parashtruesit të kërkesës të ndryshohet masa e paraburgimit me një masë më të butë alternative, siç është arresti shtëpiak, dorëzania apo masa e paraqitjes në stacionin policor, apo masë tjetër më të butë. Më 8 prill 2021, Gjykata e Apelit, nëpërmjet Aktvendimit [PN1. nr. 341/2021], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore. Parashtruesi i kërkesës ushtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe procedural. Më 19 prill 2021, Prokurori i Shtetit, nëpërmjet shkresës KMLP. III. nr. 41/2021, propozoi që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, e ushtruar nga mbrojtja e parashtruesit të kërkesës të refuzohet si e pabazuar. Më 22 prill 2021, Gjykata Supreme, nëpërmjet Aktgjykimit [PML/132/2021]: (i) aprovoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, anuloi aktvendimet e guditura të instancave më të ulëta, ktheu çështjen në rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë; dhe (ii) vendosi që parashtruesi i kërkesës të qëndrojë në paraburgim, deri në marrjen e një vendimit të ri. Më 28 prill 2021, Gjykata Themelore, bazuar në kërkesën e Prokurorit themelor për vazhdimin e paraburgimit, nxori Aktvendimin [PPrKR. nr. 234/21], nëpërmjet të cilit ia vazhdoi parashtruesit të kërkesës masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, gjegjësisht deri më 29 qershor 2021, për shkak të dyshimit të bazuar se parashtruesi i kërkesës dhe një i pandehur tjetër kanë kryer veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare apo

autoritetit zyrtarë nga neni 414, paragrafi 2 i KPRK-së, përvetësimit në detyrë, nga neni 418, paragrafi 1 i KPRK-së dhe falsifikimit të dokumenteve zyrtare nga neni 427, paragrafi 1 i KPRK-së. Kundër aktvendimit të lartcekur, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar në shkelje të dispozitave të ligjit penal dhe procedural, me propozimin që të aprovohet ankesa, të anulohet Aktvendimi i kontestuar [PPrKR. nr. 234/21], ose të ndryshohet i njëjti, të ndërpritet paraburgimi ose të aplikohet masa e arrestit shtëpiak. Më 11 maj 2021, Gjykata e Apelit, nëpërmjet Aktvendimit [PN1. nr. 468/2021], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore, të 28 prillit 2021, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë kur të pandehurve ua ka vazhduar masën e paraburgimit, ngase masat e tjera të parapara nga neni 173 të KPPRK-së, i konsideroi të pamjaftueshme për të siguruar prezencën e tyre në procedurë penale, si dhe rrjedhjen normale të procedurës dhe parandalimin e kryerjes apo përsëritjes së veprave penale. Më 25 maj 2021, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave të ligjit penal dhe për shkak të shkeljes së parimit të prezumimit të pafajësisë. Më 10 qershor 2021, Gjykata Supreme, nëpërmjet Aktgjykimit [PML. nr. 212/2021], refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, ushtuar nga parashtruesi i kërkesës kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [PN1. nr. 468/2021], të 11 majit 2021.

41. Gjykata vëren se esenca e pretendimeve të ngritura në kërkesë nga parashtruesi i kërkesës ka të bëjë me shkeljen e parimit të “prezumimit të pafajësisë”, sepse sipas parashtruesit të kërkesës nga përmbajta e tekstit të vendimit të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme vërehet qartë se ndaj tij (i) është përdorur gjuhë fajësuese, në kundërshtim me kërkesat e të drejtës për gjykim të drejtë; (ii) ende pa u vërtetuar fajësia e tij, nëpërmjet një shqyrtimi kryesor gjyqësor ku pritet të shqyrtohen të gjitha provat relevante në lidhje me këtë çështje penale.
42. Gjykata pretendimet e parashtruesit të kërkesës do t'i analizojë në pajtueshmëri me standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.
43. Rrjedhimisht, Gjykata në vijim do të paraqes: (i) parimet e përgjithshme në lidhje me “prezumimin e pafajësisë”; e më pas, do të (ii) aplikojë parimet e cekura në rrethanat e rastit konkret.

Parimet e përgjithshme në lidhje me “prezumimin e pafajësisë”

44. Gjykata ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilëve është dhe parimi *in dubio pro reo*, që nënkupton se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, dhe se në lidhje me akuzën kundër të pandehurit barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës (shih, rastet e Gjykatës: KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16; KI64/16, me parashtrues *Arben Gjukaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tabiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim i 15 nëntorit 2016, paragrafi 59; KI13/16, me parashtrues *Armend Selimi*, Aktvendim i 14 nëntorit 2016, paragrafi 44; dhe së fundmi rastet e bashkuara të Gjykatës,

KI63/19 dhe KI66/19, me parashtrues *Vahide Badivuku dhe Idriz Kelmendi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 prillit 2021, paragrafët 114-115).

45. Bazuar në jurisprudencën e GjEDNj-së, parimi i prezumimit të pafajësisë është interpretuar në kuptimin që gjykatat kombëtare: (1) nuk duhet të fillojnë procesin gjyqësor me bindjen se i pandehuri e ka kryer veprën penale (krimin) për të cilin akuzohet; 2) se barra e provës i takon organit të akuzës; 3) se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit; dhe 4) se gjykata duhet ta mbështesë vendimin e saj në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet provuar nga organi i akuzës (shih, rastin e GjEDNj-se: *Barbera, Messegue dhe Jabardo kundër Spanjës*, kërkesa nr. 10590/83, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 77).
46. Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon po ashtu që deklarimi i fajësisë i të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim. Ky parim buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe është i lidhur ngushtë me të drejtën e personit të akuzuar për t'u mbrojtur në një gjykim të drejtë. Sipas këtij parimi asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.
47. GjEDNj-ja mban qëndrimin se parimi i prezumimit të pafajësisë është njëri nga elementet e të drejtës për gjykim të drejtë, i garantuar nga neni 6 të KEDNj-së. Ky parim ndalon shprehjen e parakohshme nga vetë gjykata, të vlerësimit se personi i akuzuar për një vepër penale është fajtor përpara se kjo të provohet në përputhje me ligjin (shih, GjEDNj-së në rastin *Allen kundër Mbretërisë së Bashkuar*, të 12 korrikut 2013 dhe *Karaman kundër Gjermanisë*, të 27 shkurtit 2014). Në rastin *Karaman kundër Gjermanisë*, GjEDNj-ja ka vlerësuar se gjykatat penale janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime apo dyshime.
48. Është detyrim i organit të akuzës që bashkë me dërgimin e çështjes për gjykim, të paraqesë edhe provat mbi të cilat mbështet akuza. Kuptimi dhe zbatimi i drejtë në praktikë i parimit të prezumimit të pafajësisë është garancia kryesore për mbrojtjen e të drejtave të të pandehurit, sepse ky parim detyron organin e akuzës që të provojë fajësinë e të pandehurit, e çliron këtë të fundit nga barra për të provuar pafajësinë e tij, i jep të drejtë të zgjedhë mbrojtjen më të përshtatshme për të, të bëjë ose jo deklarime, të kërkojë prova dhe të marrë pjesë aktivisht në shqyrtimin e tyre, duke kërkuar që provat e dyshimta të interpretohen gjithmonë në favorin e tij.
49. Prezumimi i pafajësisë do të cenohet nëse një vendim gjyqësor në lidhje me një person të akuzuar për një vepër penale pasqyron mendimin se ai është fajtor para se të provohet fajësia sipas ligjit. Në lidhje me këtë, mungesa e qëllimit për të shkelur të drejtën e prezumimit të pafajësisë nuk mund të përjashtojë shkeljen e nenit 6.2 të KEDNj-së (shih, GjEDNj, rastin *Avaz Zeynalov kundër Azerbajxhanit*, paragrafi 69). Edhe në mungesë të ndonjë konstatimi formal, mjafton që të ketë disa arsyeime që sugjerojnë se gjykata e konsideron të akuzuarin si fajtor (shih, GjEDNj, rastin *Minelli kundër Zvicrës*, paragrafi 37; dhe së fundmi, *Nerattini kundër Greqisë*, paragrafi 23; *Didu kundër Rumanisë*, paragrafi 41; *Gutsanovi kundër Bullgarisë*, paragrafët 202-203). Një shprehje e

parakohshme e një opinioni të tillë nga vetë gjykata në mënyrë të pashmangshme do të bie në kundërshtim me këtë supozim (shih, rastin e GjEDNj *Nešták kundër Sllovakisë*, paragrafi 88; *Garycki kundër Polonisë*, paragrafi 66). Po kështu, një shprehje e "*bindjes së fortë se ankuesi kishte kryer përsëri një vepër penale*" gjatë procedimit për pezullimin e një dënimi me burgim me kusht, shkelte nenin 6.2 (shih rastin e GjEDNj *El Kaada kundër Gjermanisë*, paragrafët 61-63).

50. Megjithatë, sipas GjEDNj-së, pjesa e dispozitivit të një vendimi gjyqësor fillestar nuk është në vetvete problematike sipas nenit 6.2 të KEDNj-së, por janë arsyet e paraqitura në vendim. GjEDNj ka pranuar se vendimi duhet lexuar dhe në dritën e asaj se çfarë ka shqyrtuar një gjykatë e juridiksionit tjetër më vonë (shih, rastin e GjEDNj, *Adolf kundër Austrisë*, paragrafi 40, dhe *A. kundër Norvegjisë*, paragrafi 40). Ajo që është e rëndësishme në zbatimin e dispozitës së nenit 6.2 të KEDNj-së është kuptimi i vërtetë i pohimeve në fjalë, dhe jo forma e tyre literale (shih, rastin e GjEDNj, *Lavents kundër Letonisë*, paragrafi 126). Edhe përdorimi i disa shprehjeve gjuhësore, që janë për keqardhje, nuk duhet të merret si vendimtar për të arritur në konstatimin se nuk është respektuar parimi i prezumimit të pafajësisë, marrë parasysh natyrën dhe kontekstin e procedurave të veçanta (shih, rastin e GjEDNj, *Lähteenmäki kundër Estonisë*, paragrafi 45). Kësisoj, GjEDNj shtjellon faktin se një deklaratë potencialisht paragjyquese e cituar nga një raport eksperti nuk ka shkelur prezumimin e pafajësisë në procedurat për lirim me kusht nga burgu, kur një lexim nga afër i vendimit gjyqësor përjashtoi një kuptim që do të prekte reputacionin e ankuesit (kërkuesit) dhe mënyrën se si ai perceptohet nga publiku. Megjithatë, GjEDNj theksoi se gjykata vendase do duhej të ishte më e kujdesshme ose të distancohej qartë nga deklaratat mashtruese të ekspertit, ose ta këshillonte ekspertin që të përmbahej nga bërja e deklaratave të pakërkuara në lidhje me përgjegjësinë penale të ankuesit për të shmangur keqkuptimin se çështjet e fajit dhe e pafajësisë mund të jenë në çfarëdo mënyre të rëndësishme për procedurat në fjalë (shih rastin e GjEDNj, *Müller kundër Gjermanisë*, paragrafët 51-52).
51. GjEDNj po ashtu thekson faktin se edhe pse ankuesi përfundimisht u shpall fajtor nuk mund të mohojë të drejtën e tij fillestare për t'u prezumuar i pafajshëm derisa të provohet fajësia sipas ligjit (shih rastin e GjEDNj, *Matijašević kundër Serbisë*, paragrafi 49; *Nešták kundër Sllovakisë*, paragrafi 90, në lidhje me vendimet që zgjasin paraburgimin e ankuesve; shih gjithashtu *Vardan Martirosyan kundër Armenisë*, paragrafët 88-89).
52. GjEDNj, në rastin *Matijašević kundër Serbisë*, përkritazi me prezumimin e pafajësisë, theksoi se ankuesi në veçanti u ankua se gjatë shqyrtimit të procedurave të paraburgimit të tij, Gjykata e Qarkut në Novi Sad, më 2 prill 2004, e kishte shpallur atë fajtor përpara se fajësia e tij të provohej sipas ligjit; se këtë e ka bërë duke deklaruar se ka "*kryer veprat penale që janë objekt i kësaj prokurorie*"; dhe se më 22 prill 2004, Gjykata e Lartë e Serbisë, kishte dështuar të korrigjojë këtë "gabim" (shih, për rastin në fjalë, paragrafi 40). Në këtë rast, Qeveria pretendoi se formulimi i kundërshtuar, i përdorur nga Gjykata e Qarkut në Novi Sad ishte një gabim i dukshëm, ose me fjalë të tjera "një formulim i pasaktë" dhe se në vend të kësaj ajo duhej të kishte thënë se kishte "një dyshim të arsyeshëm" që ankuesi ka kryer krimet për të cilat akuzohej. Megjithatë, ankuesi kishte pohuar se arsyetimi i Gjykatës së Qarkut në Novi Sad nuk mund të hidhej poshtë si një gabim i thjeshtë, për shkak se sipas tij kishte një ndryshim thelbësor

mes një deklarate se ai kishte kryer një krim dhe një pohimi se ai thjesht dyshohej se e kishte bërë këtë krim. Vendimi i Gjykatës së Qarkut në Novi Sad ishte ankimuar në Gjykatën e Lartë të Serbisë, megjithatë GjEDNJ konstatoi se asnjëra nga gjykatat nuk kishte bërë asgjë për të korrigjuar "gabimin". Përkundrazi, Gjykata e Lartë e kishte hedhur poshtë ankesën e ankuesit, pavarësisht pretendimeve të qarta në lidhje me shkeljen e prezumimit të pafajësisë. (shih, për rastin në fjalë, paragrafi 42).

53. Në këtë rast, GjEDNJ vuri në pah se ankuesi kishte theksuar se një dënim i mëvonshëm nuk mund t'ia mohonte atij të drejtën fillestare për t'u prezumuar i pafajshëm. Prezumimi i pafajësisë, sipas nenit 6.2 të KEDNJ-së, do të shkelej nëse një vendim gjyqësor ose një deklaratë e një zyrtari publik, në lidhje me një person të akuzuar për një vepër penale, reflekton një mendim se ai është fajtor përpara se fajësia e tij të vërtetohet sipas ligjit. Në mungesë të një konstatimi formal mjafton, që në një vendim gjyqësor të përmban arsyetim ose mendim që tregon se gjykata ose zyrtari në fjalë e konsiderojnë të akuzuarin fajtor, ndërkohë që një shprehje e parakohshme e një mendimi të tillë nga gjykata vendase në mënyrë të pashmangshme do të jetë në kundërshtim me prezumimin e pafajësisë (shih rastin, *Deweer kundër Belgjikës*, të 27 shkurtit 1980, paragrafi 56, Seria A nr. 35; *Minelli kundër Zvicrës*, të 25 marsit 1983, paragrafët 27, 30 dhe 37, Seria A nr. 62; *Allenet de Ribemont kundër Francës*, të 10 shkurtit 1995, paragrafët 35 - 36, Seria A; dhe *Karakaş dhe Yeşilirmak kundër Turqisë*, ankimi nr.43925/98, paragrafi 49, i 28 qershorit 2005).
54. GjEDNJ-ja, në rastin *Matijašević kundër Serbisë* (paragrafi 46) theksoi se neni 6.2 i KEDNJ-së, rregullon procedurat penale në tërësinë e tyre, "*pavarësisht nga rezultati i ndjekjes penale*" (shih, rastin *Minelli*, cituar më sipër, paragrafin 30). Megjithatë, pasi një i akuzuar është shpallur fajtor, në parim, ajo dispozitë pushon së zbatuari në lidhje me çdo pretendim të bërë gjatë procedurës së mëvonshme të dënimit (shih, rastin *Phillips dhe Engel dhe të tjerët*, të dy të cituar më lart). Duke pasur parasysh faktet e çështjes, si dhe praktikën gjyqësore të sipërcituar, GjEDNJ në rastin *Matijašević kundër Serbisë* konstatoi se Gjykata e Qarkut në Novi Sad, në vendimin e saj të 2 prillit 2004, shpalli fajësinë e ankuesit përpara se fajësia e tij të provohej sipas ligjit, dhe se, për më tepër, Gjykata e Lartë e Serbisë, [Vendimi i 22 prillit 2004], dështoi ta korrigjojë këtë "gabim". Në lidhje me pohimet e Qeverisë së Serbisë, se formulimi i Gjykatës së Qarkut në Novi Sad ishte një gabim i dukshëm, domethënë "një formulim i pasaktë", GjEDNJ u pajtua dhe e pranoi pretendimin e ankuesit, si të bazuar kur ai theksoi se "*duhet bërë një dallim thelbësor mes një deklarate se dikush thjesht dyshohet për kryerjen e një krimi, në mungesë të një bindjeje përfundimtare, dhe se një person ka kryer krimin në fjalë*".
55. Në rastin e lartcekur, GjEDNJ vlerësoi se fakti që ankuesi përfundimisht ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me tetë vjet burgim, nuk mund t'ia mohonte atij të drejtën fillestare për t'u prezumuar i pafajshëm, derisa të provohej fajësia e tij sipas ligjit. Rrjedhimisht, në këtë rast, GjEDNJ-ja konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 6.2 të KEDNJ-së.

Zbatimi i parimeve të mësipërme në rastit konkret

56. Gjykata fillimisht dëshiron të qartësojë se kërkesa e parashtruesit të kërkesës ngre pretendime të prezumimit të pafajësisë dhe jo çështje të paraburgimit të tij nga gjykatat e rregullta, andaj edhe vlerësimi i Gjykatës do të adresojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me prezumimin e pafajësisë, në kuadër të procesit të rregullt gjyqësor, bazuar në parimet e lartcekura, në dritën e rrethanave të rastit konkret.
57. Në këtë kuptim, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se nga përmbajta e tekstit të vendimit të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme vërehet qartë se ndaj tij është përdorur gjuhë fajësuese, në kundërshtim me kërkesat e të drejtës për gjykim të drejtë, ende pa u vërtetuar fajësia e tij, nëpërmjet një shqyrtimi kryesor gjyqësor ku pritet të shqyrtohen të gjitha provat relevante në lidhje me këtë çështje penale. Përkitazi me këtë, ai i referohet rastit të GjEDNj-së, *Gutsanov kundër Bullgarisë*, aplikimi nr. 34529/10, paragrafët 201-204, ku e njëjta konsideroi se deklarimi i kontestuar nuk ishte i kufizuar në përshkrimin e “situatës së dyshimit” kundër parashtruesit, por ai e paraqiste parashtruesin si person i cili kishte kryer vepër penale, pa ndonjë cilësim apo rezervim për fajësinë e tij.
58. Në lidhje me këtë, Gjykata fillimisht i referohet pjesëve relevante të vendimit [PN1. nr. 468/2021] të Gjykatës së Apelit, e cila arsyetoi se *“Lidhur me të pandehurin Armend Osaj drejtë është arsyetuar **dyshimi i bazuar** se i njëjti në cilësinë e personit zyrtar, si Drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Thesarit në Telekomin e Kosovës, ka keqpërdorur detyrën zyrtare, duke falsifikuar shkresat zyrtare dhe ka përvetësuar pasuri të Telekomit të Kosovës, në atë mënyrë që në bazë të fletëdaljes nr.003640 me dt.19.09.2019 kishte bërë tërheqjen e 138 telefonave celularë të llojeve të ndryshme nga depoja e Telekomit të Kosovës me qëllim të shpërndarjes në kompani (klientë) të Telekomit të Kosovës për promociione me qëllim të mbajtjes dhe shtimit të numrit të klientëve për shërbime të telefonisë Mobile dhe fikse të Telekomit të Kosovës, mirëpo aparatet telefonike nuk dihet se ku janë shpërndarë dhe disa prej tyre janë mbuluar me dokumentacion të falsifikuar”*.
59. Gjykata tutje vëren se Gjykata e Apelit e ka cilësuar si të drejtë konstatimin e shkallës së parë, se ekziston *“dyshimi e bazuar”* se parashtruesi i kërkesës ka keqpërdorur detyrën zyrtare dhe ka falsifikuar dokumente, duke arsyetuar: *“... se provat e siguruara deri në këtë fazë të procedurës penale si: procesverbali mbi intervistimin e dëshmitareve B.H, ish-Kryeshefe ekzekutive në Telekomin e Kosovës, F.K ish-drejtor i financave, S. R, drejtor i departamentit ligjor, B.G, A.H, A.G, B.H, I.K, B.S, Sh.M, K.L, I.Z, V.H, G.A, R.Sh, B.A, A. G, E. O, H.F, A.G, A.B, F.B, P.G, A. P, F.M, F.G, P.Gj, D.D, R.S, O.B, dhe B.G, pastaj provat materiale si shkresat e Telekomit të Kosovës 12.02.2021, se në arkiv nuk ekziston asnjë dokument për këtë çështje, fletësekuestrimet për telefona, katër telefona celularë të sekuestruar dhe procesverbali mbi kontrollin e banesës. Ndërsa, se a do të vërtetohen faktet e cekura si më lart, mbetet të vlerësohet gjatë fazave të mëtejshme gjatë kësaj procedure penale”*.
60. Si përfundim, Gjykata e Apelit konstatoi: *“... gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë kur të pandehurve u ka vazhduar masën e paraburgimit, ngase*

masat e tjera të parapara nga neni 173 të KPPRK-së, janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së tyre në procedurë, në rrjedhjen normale të procedurës penale dhe në parandalimin e kryerjes apo përsëritjes së veprave penale, prandaj me qëllim të zbatimit me sukses të procedurës penale, caktimi i paraburgimit konsiderohet si i domosdoshëm, kurse ankesat e mbrojtësve të pandehurve janë refuzuar si të pabazuara”.

61. Tutje, Gjykata i referohet pjesëve relevante të Aktgjykimit të kontestuar [Pml. nr. 212/2021] të Gjykatës Supreme, e cila përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës, arsyetoi: “Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi i të pandehurit thekson se në aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe atë të shkallës së dytë nuk janë respektuar standardet ndërkombëtare sipas të cilave për një gjykim të drejtë ekziston një supozim në favor të lirimit të të pandehurit deri në zhvillimin e gjykimit, e cila është në përputhje me parimin e prezumimit të pafajësisë, se paraburgimi duhet të aplikohet vetëm përjashtimisht dhe duke u bazuar në rrethana personale të të pandehurit, se sipas GJEDNj-së, rreziku i ikjes nuk mund të matet vetëm sipas ashpërsisë së dënimit, por duke iu referuar disa faktorëve tjerë të rëndësishëm, se i njëjti nuk mund të ndikoj në dëshmitar pasi që shumica kanë dhënë deklarata në polici me ç’ rast ata edhe janë njoftuar me pasojat juridike të dhënies së dëshmisë së rrejshme”.
62. Në këtë kontekst, Gjykata Supreme, arsyetoi: “Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, pretendimet e mësipërme janë të pabazuara ngase në këtë çështje penalë juridike kryesisht nga provat në bazë të të cilave është ngritur kallëzimi penal, provat e nxjerra gjatë urdhër-kontrollit, procesverbalet mbi intervistimin e dëshmitareve, shkresat e Telekomit të Kosovës 12.02.2021, se në arkiva nuk ekziston asnjë dokument për këtë çështje, fletësekuestrimet për telefona si dhe provat tjera të mbledhura gjerë më tani, rezulton se **ekziston dyshimi i bazuar** se i pandehuri është kryerës i veprave penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 187 par.1 nënparagrafi 1.1 të KPPK-së për vazhdimin e paraburgimit, kurse a do të argumentohen këto fakte do të vlerësohet në fazat e mëtejme të procedurës penale”.
63. Gjykata Supreme tutje arsyetoi: “Po ashtu kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 187, par.1, nënpar.1.2, pika 1.2.2 të KPPK-së, sepse ekziston rreziku i ndikimit tek dëshmitarët të cilët ende nuk janë intervistuar nga organet e zbatimit të ligjit e që pritet të kryhen shumë shpejt për arsye se janë duke u ndërmarrë veprime për kontaktimin e tyre, ndërsa që nga fillimi i procedurës së hetimeve i pandehuri së bashku me të pandehurit tjerë në mënyra të ndryshme janë përpjekur që të ndërmarrin veprime për të ndikuar mbi dëshmitarët apo duke krijuar dëshmi të shpikur dhe atë duke krijuar dokumentacion të falsifikuar, ashtu që duke bashkëpunuar me persona tjerë, deri më tani të paidentifikuar, kanë krijuar dokumentacion të falsifikuar dhe të njëjtin e kanë futur në objektin e Telekomit të Kosovës në mënyrë të kundërligjshme, duke u përpjekur të krijojnë prova kinse gjithçka është në rregull lidhur me aparatet telefonike. Po ashtu një numër i madh i dëshmitarëve të cilët janë intervistuar kanë dëshmuar se janë kontaktuar nga të pandehurit tjerë duke i vënë në lajthitje ata në mënyra të ndryshme vetëm që t’i mbulojnë veprimet e tyre të kundërligjshme të mëhershme, andaj me lënien e të pandehurit në liri ekziston rreziku i asgjësimit, fshehjes apo ndryshimit të

provave të veprave penale, me qëllim të pengimit të rrjedhës normale të procedurës penale”.

64. Gjykata Supreme në fund konstatoi: *“Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin e pretendimeve dhe kanë dhënë arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendime duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë, ndërsa masat tjera të parapara nga neni 173 të KPPK-së janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të akuzuarit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale”.*
65. Gjykata, bazuar në standardet e mësipërme dhe nga përmbajtja e vendimeve të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme, vëren se vendimmarrja e tyre është bazuar në arsyet e “ekzistimit të dyshimi të bazuar” për kryerjen e veprave penale për të cilat parashtruesi i kërkesës akuzohet nga organi i akuzës. Ekzistimi i dyshimit të bazuar, në këtë fazë të procedurës është mbështetur në provat e administruara nga gjykatat e rregullta, duke dhënë dhe arsye gjithëpërfshirëse dhe të detajuara për përmbushjen e kriterëve ligjore si atyre të përgjithshme dhe atyre të veçanta në lidhje me caktimin dhe vazhdimin e masës së paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës (shih më sipër, paragrafët 58 dhe 62 të këtij dokumenti).
66. Thënë këtë, Gjykata qartëson se vendimmarrja e gjykatave të rregullta për arritjen në një përfundim të këtillë nuk është bazuar thjeshtë në “ashpërsinë e dënimit”, siç pretendon parashtruesi i kërkesës, për faktin se nga arsyetimi i mësipërm është e qartë se bazueshmëria e gjykatave të rregullta për caktimin dhe vazhdimin e masës së paraburgimit është arsyetuar me faktin se masat tjera të parapara nga neni 173 të KPPK-së ishin të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të akuzuarit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.
67. Ndërsa, sa i përket pretendimit se gjuha e përdorur nga gjykatat e rregullta bie në kundërshtim me parimet e lartcekura, gjegjësisht në kundërshtim me nenin 6.2 të KEDNj-së, Gjykata nuk e përjashton mundësinë që në ndonjë pjesë të tekstit të vendimeve të mos jetë përsëritur shprehja “dyshimi i bazuar”, megjithatë, Gjykata rikujton se nuk mjafton shprehja e një fraze të vetme nga përmbajtja e tekstit të vendimit, duke e nxjerrë atë nga konteksti dhe esenca e qëllimit të gjykimit në këtë fazë të procedurës penale. Qëllimi i gjykimit në këtë fazë të procedurës ishte nëse në rastin konkret u plotësuan kriteret ligjore për mbajtjen e parashtruesit të kërkesës në paraburgim, që është në plotëni me juridiksionin e tyre, si gjykata të faktit.
68. Gjykata rikujton se fare në fillim të vlerësimit të këtij rasti penal, gjykatat e rregullta në pjesën hyrëse të arsyetimit të vendimeve të tyre, shprehimisht theksuan se **“ekziston dyshimi i bazuar”** për kryerjen e veprave penale të ngarkuara nga ana e të pandehurit, bazuar në provat e administruara, në këtë fazë të procedurës. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton pjesë nga arsyetimi i Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, ku kjo e fundit theksoi se: **“Lidhur me të pandehurin Armend Osaj drejtë është arsyetuar dyshimi i bazuar, se i njëjti**

në cilësinë e personit zyrtar si Drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Thesarit në Telekomin e Kosovës, ka keqpërdorur detyrën zyrtare, duke falsifikuar shkresat zyrtare dhe ka përvetësuar pasuri të Telekomit të Kosovës, ...”.

69. Gjykata vlerëson se një formulim i tillë nuk mund të merret si gjuhë fajësuese, ndaj parashtruesit të kërkesës, aq më tepër kur në pjesët pasuese të arsyetimit të aktvendimit të saj, Gjykata e Apelit theksoi se: *“... ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri është kryerës i veprave penale, ... kurse a do të argumentohen këto fakte do të vlerësohet në fazat e mëtejme të procedurës penale*. Gjykata vëren se po e njëjta gjuhë është përdorur edhe nga Gjykata Supreme në Aktgjykimin e kontestuar. Për më tepër, kjo e fundit ka adresuar në mënyrë të detajuar pretendimin e parashtruesit të kërkesës se gjuha e përdorur nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë ishte në kundërshtim me kërkesat e nenit 6.2 të KEDNj-së, duke arsyetuar se *“ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri është kryerës i veprave penale, ... kurse a do të argumentohen këto fakte do të vlerësohet në fazat e mëtejme të procedurës penale”*.
70. Në këtë kontekst, Gjykata, duke u mbështetur në praktikën e GJENDj-së, vlerëson se në rastin konkret është evidente se gjykatat e rregullta kanë përdorur shprehjen “dyshimi i bazuar” dhe se ato nuk janë nisur thjesht me bindjen se parashtruesi i kërkesës “ka kryer veprat penale” për të cilat është akuzuar. Gjykata rikujton se GjEDNj-ja, në rastin *Matijašević kundër Serbisë* (paragrafi 46) theksoi se gjykatat vendase do të duhej të bënë dallimin thelbësor kur dikush thjesht “dyshohet” për kryerjen e një krimi, në mungesë të një bindjeje përfundimtare, dhe kur një person “ka kryer krimin në fjalë”. GjEDNj në këtë rast kishte konstatuar se Gjykata e Qarkut në Novi Sad, shpalli fajësinë e ankuesit përpara se fajësia e tij të provohej sipas ligjit, dhe se, për më tepër, Gjykata e Lartë e Serbisë, dështoi ta korrigjonte këtë “gabim”. Andaj, Gjykata vlerëson se arsyetimi i gjykatave të rregullta dallon dukshëm nga rrethanat e rastit të cituar të GjEDNj-së, sepse për dallim nga ky rast, në rastin e parashtruesit të kërkesës ka ekzistuar ky dallim thelbësor, sepse para shprehjes se i pandehuri “ka kryer veprat penale” për të cilat akuzohej nga organi i akuzës, gjykatat, posaçërisht Gjykata Supreme, përdori shprehjen dhe arsyetoi: *“se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri është kryerës i veprave penale ..., dhe se a do të argumentohen këto fakte do të vlerësohet në fazat e mëtejme të procedurës penale”*.
71. Në vlerësimin e Gjykatës, prezumimi i pafajësisë, sipas nenit 6.2 të KEDNj-së, do të shkelej nëse një vendim gjyqësor ose një deklaratë e një zyrtari publik (eksperti), në lidhje me një person të akuzuar për një vepër penale, reflekton një mendim se ai (personi i akuzuar) është fajtor përpara se fajësia e tij të vërtetohet sipas ligjit. Marrë parasysh pohimet e mësipërme, Gjykata vlerëson se shprehjet e përdoruara nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, nuk e konfirmojnë pretendimin e parashtruesit të kërkesës se ato u nisën me bindjen se parashtruesi i kërkesës është fajtor për akuzat e ngritura ndaj tij nga organi i akuzës, përderisa në arsyetimet e vendimeve të tyre shprehimisht theksohet se konstatimi i fajësisë së parashtruesit të kërkesës, do të vlerësohen nga gjykatat, në një fazë të mëvonshme të procedurës (shih, për më tepër, Gjykata Kushtetuese, rastin KI174/21, Aktvendimi i 16 shkurtit 2022, paragrafi 51, ku Gjykata theksoi: *“se nuk ka asgjë në shkresat e lëndës që tregon se gjyqtarët e gjykatave të rregullta kanë*

dhënë mendim që e kanë konsideruar parashtruesin e kërkesës fajtor para se ta kenë konstatuar atë në mënyrë të ligjshme me një vendim gjyqësor”).

72. Gjykata vazhdimisht ka përsëritur se “drejtësia” e kërkuar nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6.1 i KEDNj-së, nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Ky koncept kryesisht në aspektin praktik, në parim, nënkupton: (i) mundësinë e procedurave kontradiktore; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të procedurës, të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin e tyre; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmive të paraqitura nga pala kundërshtare; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të cilat, shikuar në mënyrë objektive, janë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e rregullta në mënyrë të duhur; dhe se, për pasojë, procedura, marrë si tërësi, do të rezultonte si e drejtë (shih, gjithashtu, Udhëzuesin Praktik të GjEDNj-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 2. “Shkalla e katërt”, paragrafi 264 dhe referencat e përmendura aty). Për më tepër, vlerësimi i drejtësisë së një procedure në tërësinë e saj, është një ndër premisat kryesore të praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GjEDNj-së (shih, në këtë kontekst, rastin e GjEDNj-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo* kundër Spanjës, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rastet e Gjykatës KI128/19, cituar më lart, paragrafi 58; dhe KI22/19, parashtrues i kërkesës: *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).
73. Më tej, Gjykata thekson se neni 6 i KEDNj-së, në një proces gjyqësor, nuk i garanton askujt rezultat të favorshëm, sepse njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI118/17, *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, paragrafi 36; dhe KI142/15, parashtrues *Habib Makiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 1 nëntorit 2016, paragrafi 43).
74. Nga përmbajtja e vendimeve të Gjykatës së Apelit dhe e Gjykatës Supreme, Gjykata konsideron se gjykatat në fjalë kanë respektuar të gjitha kërkesat e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNj-së, sa i përket parimit të prezumimit të pafajësisë, duke i dhënë mundësi parashtruesit të kërkesës dhe mbrojtjes së tij, që në këtë fazë të procedurës të paraqesin kundërshtimet e tyre, kundër organit të akuzës. Për më tepër, të gjitha argumentet që ishin relevante në lidhje me këtë gjykim paraprak u dëgjuan dhe shqyrtuan në mënyrë të rregullt nga gjykatat në fjalë.
75. Thënë këtë, Gjykata konsideron se nga përmbajtja e vendimeve të gjykatave të rregullta nuk rezulton të jetë i bazuar pretendimi i parashtruesit të kërkesës se gjykatat respektive e kanë nisur procesin gjyqësor me paragjykimin dhe bindjen se parashtruesi i kërkesës ka kryer veprat penale për të cilat akuzohej nga organi i akuzës. Sa i përket shqetësimit të parashtruesit të kërkesës se gjuha e përdorur në vendime mund t'i paraprijë gjetjes së tij fajtor në procedurat e mëvonshme, Gjykata konsideron se një pretendim i tillë është i parakohshëm, përderisa gjykatat ende nuk kanë vendosur përfundimisht për fajësinë e tij sipas ligjit.
76. Gjykata po ashtu rikujton se parashtruesi i kërkesës ngre pretendime edhe në lidhje me paanshmërinë e gjykatës (gjykimit), duke e ndërlidhur këtë shkelje me gjuhën e përdorur nga gjykatat në vendimet e tyre në këtë fazë të procedurës.

Megjithatë, siç vërehet nga pjesa pasuese e këtij pretendimi edhe vetë parashtruesi i kërkesës pohon se në këtë fazë të procedurës është e vështirë të provohet anshmëria e gjykatës në kuptimin subjektiv, andaj Gjykata nuk e sheh të nevojshme ta trajtojë veçmas këtë pretendim.

Përfundim

77. Si përmbledhje, bazuar në të gjitha shtjellimet e mësipërme, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e parimit të prezumimit të pafajësisë, i garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-së, i përket kategorisë së tretë (iii) të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj, si të tillë, të njëjtin e shpallë qartazi të pabazuar në baza kushtetuese dhe rrjedhimisht të papranueshëm, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.
78. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj, duhet të deklarohet e papranueshme, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 39 (2) dhe 59 (b) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur, më 11 maj 2022, njëzëri

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani